



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 4/1 Prot.

Tiranë, më 03. 01. 2018

V E N D I M

Nr. 1 , Datë 03. 01. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 160, datë 18.12.2017, e D. D., ku pretendohet për diskriminim për shkak të vendbanimit dhe çdo shkak tjetër, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme (në vijim MPB) dhe Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: *“Më datë 17 dhjetor 2014, nëpërmjet mediave¹ vizive jam njohur mbi propozimin e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, për ndalimin e rregjistrimit të mjeteve me timon në krahun e djathtë, në Shqipëri.”*

Më datë 17 Dhjetor 2017, nëpërmjet një mesazhi në facebook, ankuesi i është drejtuar drejtuar z. Eduard Shalsi duke i kërkuar që të rishikojë vendimin për ndalimin e importit të automjeteve me timon në krahun e djathtë nga Mbretëria e Bashkuar, pasi po dëmtohen rëndë interesat e ligjshme të komunitetit Shqiptar me banim në këtë vend. Gjatë vitit 2017, subjekti ankues i është drejtuar me shkresa zyrtare institucioneve si: Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit, ku ka kërkuar informacion

¹ https://www.youtube.com/watch?v=7fT7sUU1ojc&feature=player_embedded
https://www.youtube.com/watch?v=PGEFr_Th28w
<https://www.youtube.com/watch?v=iA-qCxnLkTg>
https://www.youtube.com/watch?v=SsVO63E8J8&feature=player_embedded

lidhur me statistikën dhe arsyet e ndalimit të importimit të automjeteve me timon në krahun e djathtë në Shqipëri. Nga ana e këtyre institucioneve, është dhënë informacioni se, në momentin e hartimit dhe miratimit të ndyshimeve² në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nuk ka patur statistika mbi aksidentet apo problematikat që kanë sjellë automjetet me timon në krahun e djathtë, në Shqipëri.

Në përfundim, ankuesi pretendon se veprimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në mënyrë të tërthortë kanë sjellë trajtimin diskriminues të komunitetit Shqiptar që banojnë në Mbretërinë e Bashkuar, duke i mohuar të drejtën për të rregjistruar automjetet e tyre me timon në krahun e djathtë në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar e ankesën nr. 160, datë 18.12.2017, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, D. D. është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese të pretenduara nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, nëpërmjet mediave vizive më datë 17 dhjetor 2017.

Në këto kushte dhe referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, **për këtë fakt**”, **ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.**

Për sa më sipër, diskriminimi i pretenduar nga D. D., sipas informacionit të dhënë prej tij ka marrë dijeni po në datën **17.12.2014**, ndërkohë që ankesa pranë Komisionerit është paraqitur në datën **17.12.2017**. Në këtë kontekst, rezulton se ankesa është paraqitur pranë KMD-së, më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për diskriminimin e ndodhur. Pra, ankesa është

² Me ligjin Nr. 175, datë 18. 12. 2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”

depozituar tej afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/dh e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së D. D., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Vendbanimi dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)